

Historia e Identitetit të Ashkalinjëve

2.0

nga Rubin Zemon


Për ta kuptuar kompleksitetin e problemeve që lidhen me pakicat e reja dhe identitetet etnike në Ballkan, ne duhet të kemi parasysh kontekstin ballkanas se si kuptohen zanafillat e kombit dhe historisë së tij. Historia dhe traditat folklorike zënë një vend të veçantë në jetën e popujëve ballkanas, ku procesi i zhvillimit etno-kombëtar ka filluar më vonë sesa në Evropën Perendimore, në shekullin nëntëmbëdhjetë e që ende është aktiv. Historia këtu nuk është aq shumë një shkencë si pjesë e mitologjisë kombëtare.

MITOLOGJIA PËRBALLË SHKENCËS NË BALLKAN

Secili komb dhe komunitet në Ballkan ka historinë mitologjike që daton nga kohërat e lashta (shpeshherë nga djepi i fjalës civilizim), që zbulon historinë e saj të lavdishme. Në mënyrë të vazhdueshme ringjallet dhe projektohet në pamje

të ndryshme në kohërat modern, veçanërisht në kriza. Popujt ballkanas mundën që nganjëherë të duken më pak të hapur dhe perceptues të ideve të reja; ata mund të duken të jenë të mbyllur brenda modeleve dhe komplekseve të inferioritetit nga e kaluara e tyre historike, sesa të hapur ndaj problemeve aktuale dhe perspektives së të ardhmes. Traditat folklorike janë të rëndësishme për popujt ballkanas sepse ato janë pjesë integrale e neomitologjisë historike, që shpesh përdorin sub-

ASHKALITË NË KOSOVË¹ III. 1



Qyetet me popullatë ashkali në Kosovë

Bazuar nga Filipe rekaceuicz, unep/grid-arendal, burimet: unmik; vlerësimi i nëntë gjendjes së pakicave etnike në kosovë (2002), oSce-uNHCr; Qendra humanitare për informimin e komuniteteve në kosovë

Ne mund t'ju qasemi këtyre teksteve vjershën në vijim, e shkruar nga Selahedin Kryeziu, autor nga Prizreni, Kosovë, në Shkurt të vitit 1999,.. që shpreh konfuzionin e një ashkaliu të rëndomt në qështjet urgjente të ballafaqimit me identitetin:

KUSH JAM UNE?

III. 2

Ata më pyesin çka jam. | Unë nuk di çka të them | Në shtëpi flas gjuhën e shqiptarëve, | Por nuk jam shqiptar.

Kush jam, edhe unë pyetem. | Shokët e mi kryesisht janë rom, | Por ne nuk jemi rom. | Ne I kemi darsmat si ata, | Dhe shpesh me ta, | Por nuk e dim gjuhën e tyre.


Gjyshi im dhe gjyshi i gjyshit tim, | Dhe të gjithë stërgjyshërit | As ata nuk e din. | Unë nuk e di kush jam | Ndoshta derisa të vdes | Unë do të injorojë atë që jam | Unë mendoj se në botë askush nuk është si ne, që injoron at që është. | çdo gjë...unë injorojë çdo gjë nga e kaluara ime | Unë nuk e di prej nga vijë | Nuk e di çka jam | dhe pse nuk e di – edhe pse nuk e di.

E marr nga Dr Marcel Courthiade (Institut national des langues et civilisations orientales – université de paris & union rromani Internationale – commissariat à la langue et aux droits linguistiques)

stancën dhe argumentet e tyre të shpjegojnë problemet me të cilat ballafaqohen. Ashkalinjët janë relativisht pakica “më e re”, që ka hyrë në skenën ndërkombtare vetëm pas krizës në Kosovë. Ekzistenca e identitetit të ashkalinjëve ishte e ditur mirë për një numër të shkenctarëve që mirren me studimet rome. Këta shkenctarë shpeshherë i kanë identifikuar ata si romë shqipfolës, para krizës në Kosovë. Ashkalinjët vetvetiu, sipas kushteve lokale, përshkak të gjuhës së njejtë dhe kulturës së ngjashme, gravituan në shqiptarë. Para krizës në Kosovë, ashkalinjët në Kosovë, kurrë nuk janë numëruar ose evidentuar, dhe kurrë nuk janë përfshirë në regjistrimin e popullates, pasi që ata kanë deklaruar vetën si shqiptarë. Ky lloj deklarimi i ashkalinjëve të vetpërrjashtuar socialisht ishte në favor të politikës kombëtare në Kosovë, gjithashtu. Me qëllim të grumbullimit të sa më shumë fakteve për diskriminimin kundër shqiptarëve në

“perëndimor” është parë si “identitet i thënë nga regjimi serb për ciganët shqip-folës”, me qëllim të zvogëlimit të numrit të shqiptarëve që jetojnë në Kosovë. Përveç kësaj kuaziparadigme, ishte fakti se përfaqësuesit nga komuniteti egjiptian morrën pjesën në negociatat e mbajtura në Rambuje si pjesë e delegacionit qeveritar serb në vitin 1999. Për këtë arsye disa anëtar të komuniteti ashkali/egjiptian në Kosovë u ndien më rehat dhe madje edhe më të sigurtë për të deklaruar identitetin e tyre të preferuar “ashkali” [III. 4].

Prania e forcave ndërkombtare dhe organizatave në Kosovë dhe përpjekja e tyre për të siguruar përfaqesim të të gjithë pakicave në Kuvendin e Kosovës dhe në trupat vendimarrëse, ka përshpejtuar procesin e manifestimit të dallimit të identitetit jorom, joegjiptian, joshqiptarë të ashkalinjëve. Ashkalinjtë kanë insistuar në marrjen e një vendi në trupat qeverisë mohojnë



III. 3 Dita e pare dhe e dytë e ashtuquajturës Festa Kombëtare e Flamurit të Komunitetit Ashkali | III. 4 Një nga posterët është përdorur në kampanjën për ngritjen e vetëdijes së identitetit etnik dhe përkatësisë të komunitetit Ashkali | III. 5 Sabit Rrahmani, Kryetar i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, Hafize Hajdini, Danush Ademi dhe Etem Arifi, deputet të Kuvendit të Kosovës, Abedin Toplica, lider i “Matica Ashkalia”, Muhamet Arifi, Drejtor ekzekutiv në Ballkan Sanflauers në Kosovë

Kosovë para 1999. Mirëpo pas krizës në Kosovë nuk ka pasur më nevojë për këto argumentime, kështuqë diversiteti në mes të shqiptarëve dhe ashkalinjëve ishte konfirmuar [III. 3].

Kështu që, duket të mos ketë ndonjë dallim kulturorë ose ndonjë tjetër, distance etnike ose kufinj të ndryshëm në mes të egjiptianëve Ballkanas në Kosovë dhe ashkalinjëve i vetmi dallim është vet-identifikimi i ndryshëm i njerëzve. Njerëzit brenda komunitetit ashkalinjë në Kosovë deklarojnë se janë njerëz të njejtë si egjiptianët, por nuk pranojnë identifikimin si egjiptian. Në një anë egjiptianët thonë se fjala ashkali është vetëm një prej emrave folklorik etnonim për egjiptianët. Megjithatë, në një anë, shumica e popullsisë në Kosovë, në shumë raste konsiderojnë ashkalinjët (gjithashtu edhe egjiptianet) të jenë shqipfolës rom, të cilët nuk dëshirojnë të pranojnë origjinën e tyre dhe janë në kërkim të identiteteve të reja. Ashkalinjët dhe egjiptianët. Në të kundërtën, afirmimi i identitetit të ashkalinjëve pas krizës në Kosovë, identiteti i egjiptianëve nga shqiptarët në Kosovë dhe nga bashkësia ndërkombëtare edhe nga disa shkenctar

çdo lidhje me romët dhe në fakt ata jetojnë jetën krejtësisht të veçantë. Pas një periudhe relativisht të shkurtër ashkalinjët ia dolën të themelojnë organizatat e tyre, siç janë partitë politike, Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, me Sabit Rrahmanin si kryetar (themeluar në dhjetor 1999) dhe organizata joqeveritare “Shpresa demokratike”, e kryesuar nga Agim Hyseni. Ekzistojnë edhe organizata joqeveritare në Fushë Kosovë dhe Ferizaj. Në zgjedhjet parlamentare në Kosovë në 2008, Ashkalinjët fituan tre deputet: Znj. Hafize Hajdini, Z. Danush Ademi and Z. Etem Arifi. Një numër i madh i ashkalinjëve nga Kosova tani jetojnë në Serbi (veçanërisht në Vojvodinë, në periferi të Beogradit dhe Novi Sad). Faktikisht, OJQ-ja më aktive e komuniteti ashkali është në Novi Sad, “Matica Ashkalia” (Zyra Qendrore e Ashkalinjëve) e udhëhequr nga Abedin Toplica. Një nga intelektualët dhe aktivistët më të shquar të OJQve nga komuniteti ashkali në Kosovë është Z. Muhamed Arifi, i cili gjithashtu është anëtar i Keshillit Konsultativ për Komunitete në qeverinë e Kosovës [III. 5].



III. 6 Familja persiane në Mesjetë | III. 7 Statuja e Izides në gërmadhat e Ashkelonit të vjetër | III. 8 Lokacioni i athqelonëve

NDËRTIMI I HISTORISE

Perveç faktit se identiteti i ashkalinjëve gëzon njohje politike dhe publike, hapsirë e madhe ekziston në arsytimin shkencorë të identifikimit të këtillë si komunitet i veçantë etnik. Deri tani në botën akademike, nuk është bërë asnjë punë shkencore me argument historike ose të tjera dhe me faktet rreth etno-gjenezën dhe historinë e ashkalinjëve si komunitet i veçantë etnik.

Udhëheqësit e komuniteti ashkali “shpejt” kanë krijuar shpjegimin e etno-gjenezës dhe historisë së tyre, të cilat janë më shumë paragjyquese dhe tregime popullore. Ekzistojnë një numër të thënave gojore për legjenden e ardhjen e këtij komunitet në Kosovë, deri më tani bazuar kryesisht në të thënat popullore dhe kuazishkencore, qëllimi kryesorë i cili i dallon ata nga romët dhe egjiptianët. Duhet të përmendim se shpjegimet për origjinën e ashkalinjëve, nuk janë të pranishme në historinë gojore të njerezve, por është e ndërtuar nga udhëheqësit e komunitetit ashkali:

ORIGJINA PERSIANE

Sipas shpjegimeve të tyre ashkalinjët fillimisht kanë ardhur nga Irani dhe kanë ardhur në Ballkan në shekullin e IV. Prandaj, ata kanë qenë populli i dytë më i vjetër këtu. Kur kanë ardhur, vetëm Ilirët kanë qenë këtu dhe ata (ashkalinjët) kanë adoptuar gjuhën e ilirive dhe ilirët kanë adoptuar fenë e ashkalinjëve p.sh islamit. (duhet të cekim se islami nuk është paraqitur deri në shekullin VII). Ashkan është emër relativisht i përhapur në Iran me origjin nga Persia e vjetër, i njohur se emër i dinastisë së lashtë persiane të quajtur “Ashkan”, pasiqe mbreti i parë i tyre “Ashkan” (megjithatë, fonologjia ose ortologjia e emrit ka mund të jetë e ndryshme në atë kohë). Ky mbret tek historianët grekë (helenet) njihet si “arsaces” dhe dinastia e tij në gjuhën angleze njihet si “parthian” ose “arsacid”. Persia nën sundimin e partianëve (228 bc – 226 ad) i referuar si “Parthia”.Partia-

nasët, të udhëhequr nga dinastia arsacid/ashkanian (Sidomos, burimet asiriane në kohën që i referohen parthians si „-ash kan”), ishin një fis kalorësish endacak nga krahina verilindore e Khorasan, një përhapur në rajonin malor midis Iranit të sotëm moderne, Afganistan, Taxhikistan dhe sundimi i tyre është shënuar me luftë me Mbretërinë romane dhe helenizim i rritur i Persisë. Zakonisht, emri “ashkan” sot nuk jep konfuzion gjinorë, ndoshta përshkak të mbarmit të tij “kan”, i famshëm nëpër stereotipet kulturore të “Gjengis Kan “ Në gjuhën farsi fjala “ashk” do të thotë “lot”, që e bënë emrin më poetik dhe më femëror [III. 6].

ORIGJINA ITALIANE

Sipas një legjende tjetër për orgjinën e tyre, ashkalinjët janë kolonistë nga roma antike, të ardhur në Shqipëri nga Italia. Për këtë arsye, ashkalinjët flasin gjuhën shqipe. Sipas këtij version popullorë-etimologjik, forma shqiptare “hashkalija” vjen nga fjalia shqipe: “hajt shko në Itali”, (sikurse është thënia popullore për Amerikën “Ha! Merr! Ik!").

ORIGJINA SEMITE

Një version tjetër i orgjinës së tyre ka lindur sipas të cilit, kanë origjinën nga qyteti Ashkelon në Palestinën Biblike, p.sh, nëse flasim në përgjithësi, sikurse secili popull në Ballkan, ashkalinjët kanë origjinën e tyre nga kohërat më të lashta dhe është e ndërlidhur me civilizimin dhe religjionin. Ashkelon ose Ashqelon është një vend bregdetar në jug të Izraelit. Porti i lashtë detar i ashkelonëve daton që nga koha e bronzit. Gjatë historisë, është sunduar nga kananitët, filistinët, izraelitet, babilonasit, greket, feniksit, romakët, persianët, egjiptiane, muslimanët, britanezët dhe kryqtarët. Është shkatërruar nga mamluksët në vitin 1270 dhe është nxjerrur nga përdorimi. Qyteti modern i ashkalinjëve është ndërtuar nga qyteti i Al-majdal në vitin 1596 ishte fshat i 559 shtëpive muslimane, dhe në vitin 1931 jetonin 6,166 musliman dhe 41 të krishterë. [III. 7,8].



III. 9 “Teatri Ashkali” në festimin e përvjetorit të minoritetit të Ashkalinjëve | III. 10 Zjarri i farkëtarit | III. 11 Fëmiju ashkali luan në fshatin Dubravë afër qytetit të Ferizajit

ETIMOLOGJIA E FJALËS “ASHKALI”

Fjala “ashkali” përdoret në Fushë Kosovë (por jo në Dukagjin), si dhe në disa vende kufitare të ish republikës së Maqedonisë me Kosovën (rrethi i Shkupit dhe tetovës).

Rajko Gjurić shkroi që fjala ashkal/ashkali është përmendur nga shkrimtarët orientalist dhe bizantin në debatet rreth popujve sllav dhe ant, edhe pse kjo nuk ka referencë të plotë. Debatet rreth popujve sllav dhe ant në historiografi ishin nga shekujt IV deri në VI.

Disa antropolog dhe filolog kanë bërë analiza të etimologjisë së fjalës “ashkali”. Ata mendojnë se fjala “ashkali” vjen nga fjala shqipe “eshkë” qymyr druri (ashkël e drurit), që farkëtarët ashkalinjë kanë përdorur për të ndezur zjarrin.

Procesi i përgatitjes së qymyrit të drurit për farkëtarët është shumë i vështirë dhe vetëm disa persona janë në gjendje ta bëjnë; këta persona marrin etnonimin punues të eshkes/ashkës prandaj quhen “ashkali”.

Shpjegimi popullor i fjalës ashkali, se ky emër ju jepet egjiptianëve nga romët, pasi që dëshirojnë të dallohen nga ata por kanë ngjyrë të ngjashme të lëkurës.. “Ash” do të thotë “e zezë”, dhe “kali” që do të thotë kali i zi! Por në gjuhën rome “kali” do të thotë e “zezë” dhe “ash” do të thotë “ndal”. Në Ballkan fjala “ash” është term turk kur njerëzit duan të thonë “ska më”, “i shpenzuar”, edhe kur dikush apo diçka do të dëbohet (largohu nga këtu). Në botën akademike vetëm Marcel Courthiade doli me pikëpamje të qartë për çështjen e emrit të “ashalinjëve” në shkrimin e tij “Ju that ashkali? Unë e kuptova Egjiptian” duke shpjeguar se ashkali është një nga etnonimet ose pseudonimet për komunitetin e egjiptianëve në Ballkan.

BIBLIOGRAFI

Bacler A., 2007. *The development of identities among the population of Gypsy origin in Kosovo: Ashkali, Egyptians and Roma, Sprawy Narodowościowe, Warsaw.* | **Duijizing G., 2000.** *Making of Egyptians in Kosovo and Macedonia, Religion and Politics of identity in Kosovo, London* | **Eriksen T. H., 1993.** *Ethnicity and Nationalism, London.* | **Courthiade M., 2002.** *Vous avez dit Ashkali? J'avais compris Egyptien. Bulletin de l'INALCO, Paris.* | **Courthiade M., 2003.** *Quelques Proverbes Des Ashkalo-Egyptiens De Prishtina- recueillis en 1980 par Lumia Osmani Kuc et suivis de quelques poèmes recents d'auteurs divers, INALCO, Paris.* | **Marushiakova E. and others, 2001.** *Identity formation among the minorities in the Balkans: The case of Roma, Egyptians and Ashkali in Kosovo. Minority Studies Society Studii Romani, Sofia.*

¹ Të gjitha shkrimet referuar Kosovës në këtë tekst, qoftë teritorit, institucioneve, ose popullit duhet të kuptohen në pajtueshmëri të plotë me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe duke mos paragjykuar statusin e Kosovës.